



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 4  
Prishtinë, më 07.11. 2017, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE  
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mosiloviq, zëvendëskryetar i dytë, Xhelal Sveçla, Drita Millaku, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

**Mungoi:** Ramiz Kelmendi, Ismet Beqiri, Blerim Kuçi

**Përfaqësuesit nga Qendrës së Gjenevës për Siguri, Zhvillim dhe Sundimin e Ligjit(DCAF):** Antje Fritz- Zëvendës shefe e Divizionit për Evropën Juglindore, Luanda Domi-zyra e DCAF Kosovë, Nicola Brassili- asistente e DCAF në Gjenevë, Fitim Hoxha-praktikant në DCAF-Gjenevë

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Njomza Arifi-praktikante

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Haxhi Shala, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

## Rend i ditës:

Takimi i Komisionit me përfaqësuesit e Qendrës së Gjenevës për Siguri, Zhvillim dhe Sundimin e Ligjit.

***Kryetari i komisionit** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

**Kryetari**, falënderoi përfaqësuesit e DCAF që janë prezent, për të njoftuar Komisionin dhe anëtarët që janë për herë të parë në këtë Komision, lidhur me punën dhe bashkëpunimin që do të ketë DCAF përgjatë këtij mandati.

**Antje Fritz, Zëvendës shefe e Divizionit për Evropën Juglindore**, fillimisht bëri një prezantim lidhur me rolin dhe funksionin e Qendrës së Gjenevës, ku u theksua që mandati i saj është që të ofroj ekspertizën, praktikat më të mira sa i përket sektorit të sigurisë, të drejtave të njeriut dhe aspekteve të tjera të drejtësisë dhe mbrojtjes. Gjithashtu theksoi që sa i përket mbështetjes financiare të DCAF është kryesisht nga Qeveria zvicerane por janë edhe shtete të tjera dhe BE-ja. Gjithashtu theksoi se nga ana e tyre ofrohen edhe këshilla strategjike për qeveritë dhe organizatat e caktuara, ndërtimin e kapaciteteve profesionale. Po ashtu tregoi lidhur me bashkëpunimin me organizata të tjera siç është OSBE, NATO etj.

Më tutje theksoi se është ofruar mbështetje edhe për Policinë e Kosovës si dhe Inspektoratin Policor të Kosovës, gjithashtu mbështetje është dhënë përgjatë rishikimit të sektorit të sigurisë para shpalljes së pavarësisë, gjithashtu mbështetje në një sërë temash, në procesion e shqyrtimit të projektligjeve, të dhënave personale, organizimi i një sërë tryezash me tema specifike.

**Kryetari**, duke iu referuar tryezës e që do të mbahet me datë 8 nëntor, theksoi që nga ana e anëtarëve të Komisionit do të jepet kontributi për temat që do të trajtohen.

**Rexhep Selimi**, lidhur me bashkëpunimin me DCAF theksoi se ka referenca të mira përgjatë viteve dhe falënderoi përfaqësuesit e DCAF për këtë mbështetje. Ndërsa sa i përket mbështetjes së mëtutjeshme të Komisionit, kërkoi që mbështetje të ofrohet përgjatë shqyrtimit të projektligjeve të cilat janë paraparë në strategjinë legjislative, duke shtuar që për Projektligjin për pensionimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës të ofrohet mbështetje përgjatë shqyrtimit të tij.

**Fatmir Xhelili**, fillimisht falënderoi për kontributin dhe mbështetjen e dhënë nga ana e DCAF në mbështetje të Komisionit. Ndërsa për mbështetjen e mëtutjeshme kërkoi që të jetë për projektligjet në aspektin e dallimeve nga direktivat e BE-se dhe mënyrën se si rregullohen në të drejtën e BE-së çështje të caktuara, në mënyrë që mos të ketë nevojë për plotësim ndryshime të ligjeve në vazhdimësi për këtë çështje.

**Kryetari**, duke iu referuar reformimit të sektorit të sigurisë, kërkoi që nga ana e DCAF do të ishte i mirëpritur një mbështetje në këtë proces, duke qenë se në vitin 2014 është bërë Analiza e Rishikimit Strategjik të sektorit të Sigurisë, ndërkohë rrethanat rajonale dh globale kanë ndryshuar. Për këtë propozoi organizimin e ndonjë tryeze.

**Antje Fritz- Zëvendës shefe e Divizionit për Evropën Juglindore,** lidhur me kërkesën e Kryetarit përgjatë procesit të rishikimit të sektorit të sigurisë, theksoi se në aspektin politik nuk mund të përfshihen, ndërsa aspektin teknik janë të gatshëm të ofrojnë mbështetje. Ndërsa sa i përket ligjeve, theksoi se për Ligjin për përgjimin e telekomunikimeve nëse inicohet mbikëqyrja e këtij ligji, mund të ofrohet mbështetje, gjithashtu edhe aspekte të tjera gjatë shqyrtimit të projektligjeve.

**Xhelal Sveçla,** ngriti çështjen e problematikës së mungesës së energjisë elektrike në pikën kufitare(mes Kosovës e Serbisë në fshatin Kapi të Kamenicës), e cila ka ardhur si rezultat i dialogut Kosovë- Serbi dhe marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2015. Për këtë arsye kërkoi që nga ana e Komisionit të drejtohet kërkesë institucioneve kompetente, të ndërmarrin masat për funksionalizimin e kësaj pike kufitare, pasi aktualisht përdor vetëm gjeneratorë.

**Fatmir Xhelili,** propozoi që fillimisht të kërkohet sqarim nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe më pas të bëhet një analizë për këtë çështje.

**Kryetari,** theksoi që si të vendos Komisioni për këtë çështje mund të procedohet kjo çështje, qoftë edhe përmes pyetjeve parlamentare.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur

Mbledhja përfundoi në orën 10:40

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

---

**Haxhi Shala**